REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 20/17
Datë/Datum. 22.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW

PSH. Nr. 20/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej: z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi – Referues, z. Blerim Dina - anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE "Uni Project" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja teknike e ndërtesave Qeveritare", me nr. të Prokurimit: MAP202/16/202/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Administratës Publike, më: 15.02.2016, mori këtë :

V E N D I M

I. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE "**Uni Project**" - Prishtinë, lidhur me procedurën e prokurimit me titull "Mirëmbajtja teknike e ndërtesave Qeveritare", me nr. të Prokurimit: MAP202/16/202/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Administratës Publike (MAP).

II. **Anulohet,** vendimi për dhënie të kontratës i autoritetit kontraktues - Ministria e Administratës Publike (MAP), lidhur me procedurën e prokurimit me titull "Mirëmbajtja teknike e ndërtesave Qeveritare", me nr. të Prokurimit: MAP202/16/202/211, si i pa bazuar dhe lënda kthehet ne **Ri-vlerësim per Lot 1, 2 dhe 3 konform nenit 72 të LPP-së.**

III. Mos respektimi i këtij vendimi e detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj autoritetit kontraktues.

IV. Meqenëse pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues "Uni Project" - Prishtinë janë të qëndrueshme, konform nenit 118.3 të LPP-së, i kthehet sigurimi i ankesës.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë është bërë me dt: 12.12.2016, ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt:28.12.2016, ndërsa në këtë aktivitet të prokurimit kanë marr pjesë pesë operatorë ekonomik.

Njoftimi për dhënie të kontratës është bërë me dt:06.01.2017, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "MSS" - Prishtinë.

Letra standarde për tenderues të pasuksesshëm është dërguar me dt:06.01.2017.

Kërkesa për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik "Uni Project" - Prishtinë është bërë me dt:11.01.2017.

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim është marr me dt:13.01.2017

Operatori ekonomik "Uni Project" - Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP më 20.01.2017, me nr. të protokollit, 20/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të OE "MSS" - Prishtinë, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së nr. 04/L-042, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar procedurën e zhvilluar lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues në raportin e datës: 03.02.2017, ka konstatuar se AK-ja, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së dhe se pretendimi ankimor i parashtruesit të ankesës në lidhje me Lot 2 është i qëndrueshëm, për faktin se çmimi i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë për Lot 2 sipas rregullores rezulton të jetë çmim Jo-Normalisht i ulët, ndërsa lidhur me pretendimet ankimore te OE ankues eksperti shqyrtues, ka sqaruar ne raportin e tij se për Lot 1 dhe 3 duhet të aprovohet vendimi i AK-së, për dhënie të kontratës.

Prandaj, eksperti shqyrtues, duke u bazuar në sqarimet e dhëna në raport të ekspertizës i ka propozuar panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe njëherit i ka propozuar panelit shqyrtues që të aprovohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës për Lot 1 dhe 3 ndërsa për Lot 2 , eksperti shqyrtues ka propozuar që ky aktivitet i prokurimit të Ri-vlerësohet.

OE ankues "Uni Project" - Prishtinë përmes parashtresës ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues të dhënë në raportin e datës 03.02.2017.

AK-ja, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me raportin dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues, për këtë aktivitet të prokurimit.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, më 15.02.2017, ne te cilën ishin prezent anëtarët e Panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesi i autorizuar OE ankues, ndërsa përfaqësuesi i AK-së nuk ishte prezent edhe pse ishte ftuar me procedure të rregullt. Në seancë u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, përgjigjja e AK-së mbi raportin e ekspertizës si dhe parashtresa e OE ankues lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Gjatë prezantimit në seancë, përfaqësuesi i autorizuar i OE ankues z. Vrella deklaroj: Siç kemi cek në ankesën tonë dërguar në OSHP, kompania jonë nuk pajtohet me përmbajtjen e ekspertizës për lot.1 dh e 3, për arsye se nuk ka ofruar argumente të bazuara në LPP, dhe ligj të punës për personelin që e ka dy kontrata të punës për të njëjtin orar të punës. Pikat kontestuese të ankesës do ti prezantoj si në vijim: AK-MAP, ka përzgjedhur OE fitues "MSS", që ka prezantuar kontrata të punës për gjithsej 5 inxhinier që punojnë njëkohësisht në dy vende pune. Disa nga ta punojnë në Postë Telekomin e Kosovës dhe disa në një OE konkretisht kompania "Rexha".

OE "MSS" ka prezantuar këtë personel që do punojnë nga ora 08.00 deri në 16.00. Kjo është në kundërshtim me ligjin e punës por edhe me ligjet e fizikës pasi një trup nuk mund të prezent në dy vende. Gjithashtu pjesë e këtij safi është prezantuar me pagë nën minimumin e pagës e përcaktuar me vendimin 04/33 të Qeverisë së Kosovës për pagë minimale. Për këtë arsye oferta e OE "MSS" do duhej refuzuar nga AK-MAP dhe të shpallet e papërgjegjshme.

Po ashtu OE "MSS" për lot.1 nuk ka prezantuar plan të menaxhimit siç shihet në ofertën e tyre, për lot.1 e ka lënë bllanko, edhe për këtë arsye oferta duhet refuzuar dhe shpallet e papërgjegjshme. AK-MAP, ka shkel nenin 65 deri 70 të LPP-se, sa i përket kapaciteteve teknike dhe ekonomike-financiare pasi OE "MSS" nuk ka ofrua personelin e kërkuar në bazë të ligjit. Ju ofroj panelit shqyrtues si provë me emrat e nënvizuar për inxhinierët që punojnë në dy vende pune, kopje kontratës me PTK-në.

Kërkojmë nga paneli shqyrtues, të mos aprovoj si valide punësimin e punëtorëve në dy kompani private apo publike me orar nga 08 deri në 16. Po qe se aprovohet një gjë e tillë që është kundërshtim me ligj të punës, atëherë "Uni Project", do të thirret në precedent të rastit për këtë

çështje në çdo prokurim publik të Qeverisë së Kosovës. Kërkojmë nga paneli i OSHP-së që pas shoshitjes së fakteve të marr vendim për të dërguar lëndën në rivlerësim për lot.1 dhe 3, ndërsa përkrahim mendimin e ekspertit që lënda e kontestuar të kthehet në rivlerësim edhe për lot.2

I propozojmë panelit shqyrtues që te aprovoj ankesën tonë si te bazuar dhe lëndën ta kthej në Rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues deklaroj: Lidhur me pretendimin ankimor për kontratat e stafit që i prezantoj edhe në seancë përfaqësuesi i OE ankues, sqaroj se kontratat janë të nënshkruara në Nëntor vitit 2016 me OE "MSS". Për kontratat e dyfishta për të cilat pretendon se ka në ofertë, kjo qëndron se disa prej pjesëtarëve të stafit kanë kontrata edhe me OE "Rexha", mirëpo ato kontrata janë të nënshkruara në vitin 2010.

Kontrata të cilat OE "MSS" i ka të nënshkruara me stafin profesional, janë në Nëntor të vitit 2016, dhe për të njëjtit paguan edhe kontribute në ATK, çka është dëshmi shtesë se këta janë punëtor të OE "MSS".

Lidhur me pretendimin ankimor se çmimi i OE të rekomanduar për kontratë është jo normalisht i ulët, në raport kam sqaruar se për lot.2, ky pretendim qëndron plotësisht, me arsyetimin e dhënë në tabelën që kam paraqitur në ekspertizë. Ndërsa për dy lotet tjera ky pretendim nuk qëndron pasi janë vetëm dy oferta, dhe në rastin konkret rregullorja për çmime jo normalist të ulëta nuk mund të nxirret 30% me vetëm dy oferta.

Kryetari i panelit shqyrtues pyeti ekspertin shqyrtues, se a ka dëshmi se kontratat janë të shkëputura?

Në përgjigje eksperti shqyrtues deklaroj: Nuk ka dëshmi për shkëputje të kontratave.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues z.Vrella deklaroj: Lidhur me deklarimet e ekspertit shqyrtues, sa i përket punëtorëve pranë ATK-së, pothuaj secila kompani apo OE, angazhon ekspert të cilët nuk kanë orar të caktuar, pra edhe pas orarit të rregullt të punës dhe normalisht të hyrat për këta ekspert duhet deklaruar pranë ATK-së, mirëpo kjo deklaratë nuk është relevante për këtë çështje pasi AK-ja, shumë mirë ka bërë të qartë në dosje se orari punës për kategori të punëtorëve është prej orës 08.00 deri 16.00.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues të AK-së, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues të cekur në ekspertizë, parashtresës së OE ankues, parashtresës së AK-së, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se AK-ja, konform nenit 72 të LPP-së, duhet të kërkoj sqarime shtesë në lidhje me kontratat e stafit profesional të OE të rekomanduar për kontratë "MSS", për faktin se në ofertë OE i rekomanduar për kontratë i ka dorëzuar disa kontrata të punës të lidhura në mes të stafit profesional dhe OE "MSS" në muajin nëntor 2016 dhe poashtu i njëjti staf ka kontrata edhe me operator ekonomik tjerë ku disa kontrata janë të nënshkruara në vitin 2010. Gjithashtu paneli shqyrtues konstaton dhe vlerëson se është e nevojshme edhe verifikimi i pagës se ofruar për stafin profesional për faktin se në kontratat e tyre thuhet se paga për punëtor është 130 euro, ndërsa sipas vendimit të këshillit ekonomik – social paga minimale për punëtor është 130 euro deri në moshën 35 vjeçare, ndërsa 170 euro për të punësuarit mbi moshën 35 vjeçare, andaj është i

nevojshëm sqarimi i çështjes së pagave të punëtoreve të stafit të OE "MSS" dhe çështja e orarit të punës. Gjithashtu për lot 2 autoriteti kontraktues gjatë rivlerësimit duhet ti përmbahet dhe të zbatojë nenin 61 të LPP-së dhe Rregulloren për Tenderët Jo-normalisht të ulët.

Duke u bazuar në të gjitha sqarimet dhe konstatimet e lartpërmendura, paneli shqyrtues konstaton dhe vlerëson se AK-ja nuk e ka respektuar nenin 59, 61 të LPP-së, pasi që nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave në harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht nuk janë aplikuar dispozitat e nenit 61 dhe nuk është marr parasysh rregullorja për tenderët jo-normalisht të ulët.

Prandaj Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, si dhe duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran MILENKOVIĆ

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Ministria e Administratës Publike"

1x1 OE – "Uni Project" - Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së.